

## Dora e ngrohtë e Europës

OSBE-ja hapi në Shqipëri një "Prezencë" më 27 mars 1997. Qëllimi i përgjithshëm ka qenë forcimi i organeve institucionale kryesore të vendit për të ndërtuar një sistem demokratik sigurish dhe balancash, si dhe zhvillimi i një niveli më të lartë dialogu mes palësh për të nritur besimin te këto institucione. Kur shpërtheu kriza e Kosovës në vitin 1998, Prezenca u ngarkua me rolin e monitorimit të kufijve dhe gjatë periudhës pasardhëse mars-shtator ajo luajti një rol kryesor në bashkërendimin e reagimit ndërkombëtar dhe atij shqiptar ndaj krizës së refugjatëve. Përveç kësaj, nga shtatori 1998 deri në prill 2002, Prezenca bashkëkryesoi një forum joformal organizatash ndërkombëtare donatore, aktive në sigurimin e ndihmës teknike. Në vitin 2002, Prezenca kontribuoi për përfundimin e bojkotimit dhe kthimin e opozitës në parlament, si dhe ndihmoi në hapjen e rrugës për zgjedhjen konsensuale të Presidentit të Republikës. Gjatë viteve 2003, 2004 dhe 2005, ajo siguroi ndihmë teknike si për reformën zgjedhore edhe për ligjin e pronave. Prezenca e OSBE-së drejtohet nga Kryetari i Prezencës, i cili ka përgjegjësinë e përgjithshme për politikën, planifikimin dhe funksionimin e Prezencës. Veprimtaritë tematike të Prezencës zbatohen nga tre departamente: Dimensioi Njerëzor; Mirëqeverisja në Çështjet Ekonomike dhe Mjedisore; dhe Departamenti për Bashkëpunim në Çështjet e Sigurisë. Puna e këtyre departamenteve dhe zyra e Kryetarit të Prezencës mbështeten nga Zyra e Administrimit të Fondeve. Një Zyrë për Koordinimin e Zyrave Rajonale dhe Projekteve vepron si urë lidhëse midis selisë qendrore të Prezencës në Tiranë dhe zyrave të saj rajonale. Zyrat rajonale të Prezencës ndodhen në Shkodër, Kukës, Vlorë dhe Gjirokastër. Ato mbajnë kontakte me aktorët vendorë, si përfaqësuesit e qeverisë, policinë, gjyqësorin, median dhe grupet e shoqërisë civile. Përveç kësaj, ato përfshihen në realizimin e projekteve në nivel vendor. Prezenca i siguron ndihmesë organizatave të shoqërisë civile që kanë kapacitete për të ndërtuar një qeverisje demokratike nëpërmjet mobilizimit dhe përfshirjes së qytetarëve në vendimarrje. Mes veprimtarive të tjera, Prezenca lehtëson bashkëpunimin midis shtetit dhe aktorëve të shoqërisë civile në nivel qendror



(Vijnë në faqen 3)

## Verë 2006: Sërish në "shoqërimin" e plehrave

### OSBE ndihmon në zbatimin e ligjit për parandalimin e ndotjes së mjedisit në nivel lokal

Tirana ka pasur një rritje të shpejtë të popullsisë gjatë këtyre viteve të fundit. Në 2005, prodhimi i mbeturinave të 600 000 banorëve ishte 0,8 kg për banor në ditë, mbeturina të cilat klasifikohen si mbeturina të ngurta urbane. Brenda angazhimit në drejtim të një mjedisi të pastër, është bërë një hap përpara nga Bashkia e Tiranës, me hartimin e Strategjisë Lokale për një Mjedis të Shëndetshëm, për vitet 2005-2008.



Lexo fq. 5

(Vijnë në faqen 4)



# Konferenca "Për Përmirësimin e Cilësisë së Ajrit"

Berisha: Pas Kabulit, qyteti i Tiranës ka treguesit më të lartë të pluhurit



Pas Kabulit, kryeqyteti ynë, është qyteti me ndotjen më të madhe nga pluhuri dhe gazrat e makinave. Alarmin e dha vetë kryeministri Z. Sali Berisha, duke theksuar se ndërtimi dhe cilësia shumë e keqe e karburantit që përdoren për automjetet janë dy shkaktarët kryesorë të ndotjes. Ai ka kritikuar Bashkinë e Tiranës dhe ka kërkuar nga ministria e linjës, kontrolle të rrepta sa i përket karburantit që duhet të futet në vend. Ndërsa ministri i Mjedisit, Z. Lufter Xhuveli, është përpjekur të pasqyrojë një situatë të përmirësuar në lidhje me cilësinë e ajrit, por ka pranuar se gjendja mbetet problematike.

Më 27 Qershor 2006 Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, organizoi konferencën "Për Përmirësimin e Cilësisë së Ajrit".

Në fjalën e hapjes ministri Lufter Xhuveli vuri në dukje situatën reale të ajrit në Shqipëri, i cili është problematik në qendrat e mëdha urbane. Gjithashtu në këtë fjalë u cilësuan dhe aktivitetet të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në cilësinë e ajrit. Kështu si sektorët më të ndikueshëm u përmendën sektori i ndërtimeve si dhe sektori i transportit.

Duke u bazuar në të dhënat disavjeçare të monitorimit nga ana e institucioneve shkencore në vendin tonë të kontraktuara nga Ministria e Mjedisit, si dhe nga të dhënat e agjencive ndërkombëtare për gjashtë treguesit kryesorë të cilësisë së ajrit rezultoi se shqiptarët, në qytetet kryesore të vendit, thithin ajër 2 deri në 3 herë më të

ndotur se qytetarët e vendeve të tjera evropiane kur është fjala për dy kategori të grimcave të pluhurit. Nga ana tjetër shqiptarët thithin ajër më të pastër dhe më pak të ndotur se shumica e banorëve të tjerë të kontinentit evropian për katër tregues të tjerë siç janë pëmbajtja e dyoksidit të azotit, dyoksidit të sulfurit, plumbit etj të cilat janë mesatarisht në nivel dy herë më të ulta se normat e lejuara nga standardet e Bashkimit Evropian. Kjo mund të vihet re edhe nga hartat satelitore për cilësinë e ajrit të 26 Qershorit 2006.

Rritja e cilësisë së ajrit mbështetet edhe nga rritja e sipërfaqeve të rrugëve të rehabilituara apo të asfaltuara, rritja e sipërfaqeve të gjelbra, respektimi më i mirë i kriterave urbanistike, përmirësimi i legjislacionit, rritja e kërkesave për zbatimin e kushteve të lejeve mjedisore dhe vendosja e sanksioneve për të gjithë ata që i shkelin ato - shtoi Xhuveli.

Më pas fjalën e mori Kryeministri i vendit Berisha, i cili qëndroi në dy problemet më kryesore të cilat duhet të gjejnë zgjidhje: kontrolle të rrepta në pikat doganore për importuesit e karburanteve dhe pëmbysje të raportit të makinave të vjetra me ato të reja në Shqipëri. Këto janë dy nga masat urgjente që kryeministri Berisha ka kërkuar të

deklaruar se ARMO është përgjegjësi kryesor për këtë ndotje. Por kritikën e Berishës kanë rënë edhe mbi ndërtimet e shumta që nuk respektojnë asnjë kriter të mbrojtjes së mjedisit dhe në politikën vendore që ndiqet për punimet në infrastrukturën rrugore, që bëhet shkak për këtë situatë të krijuar. "Pas Kabulit, qyteti i Tiranës ka treguesin më të lartë të pluhurit në dy kontinentet sepse hapen 30 rrugë, punimet e të cilave vazhdojnë për tre vjet, sepse janë të nalla rastet kur pallatet në ndërtim mund të marrin masa mbrojtëse për mospërdhapjen e pluhurit", - theksoi Berisha. Pyllezimi, sipas tij, është përpjekja më e madhe për përmirësimin e cilësisë së ajrit. Për të realizuar këtë, sipas tij, janë siguruar fondet nga Ministria e Mjedisit për rreth 7 mijë hektarë për pyllezim.

- 3 herë më i ndotur është ajri në Tiranë se qytetet e tjera evropiane
- 40 për qind është më pak i ndotur ajri në Elbasan se vitin e kaluar
- 7 mijë hektarë tokë priten të pyllezohen nga Ministria e Mjedisit
- 80 për qind e makinave në Shqipëri janë të vjetra dhe me naftë
- 20 për qind e makinave në Shqipëri janë të reja dhe me benzinë

menen për përmirësimin e ajrit në vend. Duke folur për ndotjen e zonave të tjera të vendit, kryeministri ka kërkuar privatizimin e rafinerisë së Ballshit, si dhe ka

Kryeministri i vendit tregoi angazhimin maksimal të Qeverisë që ai drejton në përmirësimin e kësaj situatë alarmante për qytetet e mëdha.

Ornela SHOSHI

## E Shtuna e tretë e Qershorit - Dita e Liqenit të Shkodrës

E shtuna e tretë e qershorit, u vendos të jetë dita e Liqenit të Shkodrës.

Ky eveniment mjedisor u vendos me nënshkrimin e një deklaratë të përbashkët midis Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të

Nënshkrimi i kësaj deklaratë është vetëm një pikë kulmore e shumë iniciativave të tjera në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të zonës në zbatim të principeve mjedisore dhe rritje e bashkëpunimit dypalësh për menaxhimin e integruar të liqenit

një dite të përbashkët me Malin e Zi për Liqenin e Shkodrës, e cila do të njihet zyrtarisht dhe do të festohet çdo vit.

Dita simbol e Liqenit të Shkodrës, që nga ky vit, do të fillojë të jetë një ditë e veçantë me festime të shumëllojshme, ku nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme do të promovohen në shumë vlerat natyrore dhe kulturore të kësaj treve si edhe të tërhiqet vëmendja e popullsisë lokale dhe institucioneve ndërkombëtare, në drejtim të mbrojtjes së liqenit dhe territoreve përreth tij.

Do të jetë kjo ditë që do të kulmojë përpjekjet e komuniteteve që jetojnë në të dy anët e liqenit për të dhënë atij një dimension tjetër, më të vlefshëm, me të preksëm për ta dhe në afër koncepteve evropiane.

Kjo ditë përkoi dhe me hapjen e pikës së kalimit në molin pranë urës së Bunës nga transporti nëpërmjet liqenit që është një rrisi mjaft e dobishme për marrëdhëniet dypalëshe me Malin e Zi.



Shqipërisë, Z. Lufter Xhuveli dhe Z. Boro Vuçiniç, Ministër i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Malit të Zi, në datën 18 Qershor 2006.

dhe zonave përreth tij.

Kjo ditë e Liqenit është përcaktuar në konsultime me grupet e ndryshme të interesit për të rënë dakord mbi përcaktimin e

Ornela SHOSHI

**Takimi kombëtar i 50 shoqatave të përdoruesve të pyjeve dhe kullotave; Federatave të Pyjeve Komunale që përfaqësojnë përdoruesit e Pyjeve në Qarkun Dibër, Kukës, Korçë, Berat dhe Shoqata Kombëtare**

Të mbledhura në Sallën e Muzeut Historik Kombëtar më datën 23 Qershor 2006, në një takim kombëtar të organizuar nga Shoqata Kombëtare e Pyjeve Komunale dhe Lëvizjes MJAFT!, me pjesëmarrjen e 50 shoqatave të përdoruesve të pyjeve dhe kullotave nga gjithë rajonet e Shqipërisë, katër federatave rajonale të Kukësit, Dibërës, Korçës e Beratit, të përfaqësuesve nga trupi diplomatik dhe donatore në Tiranë, si dhe përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, përdoruesit e pyjeve dhe kullotave komunale në fund të takimit, miratuan tekstin e rezolutës nr. 4. Komunitetet e përfaqësuar nga Shoqatat dhe Federatat kanë treguar dhe vazhdojnë të tregojnë kujdes për mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve komunal në Shqipëri. Krahës punës që ato kanë bërë, kërkohet që të shpejtohen reformat dhe fillimi i punës për zhvillimin e Burimeve Natyrore.

OSH

## Promovohet "Strategjia Kombëtare e Mjedisit"

Promovimi i pëmbledhjes së Strategjisë Kombëtare të Mjedisit (SKM) u realizua më datë 13 korrik, në konferencën e zhvilluar pranë mjedisëve të Hotel "Sheraton" në Tiranë. Konferenca për prezantimin e SKM-së u zhvillua në vijim të kështillimit mbarëkombëtar të nisur nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave me ndihmën e Projektit ELPA, i financuar nga programi CARDS. Të pranishëm në takim ishin: Kryeministri i Shqipërisë, z. Sali Berisha, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, z. Lefter Xhuveli, Zv/Ministri i MMPAJ, z. Taulant Bino, Zv/Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, z. Armand Tefti, Zv/Ministri i Financave, z. Florian Mima, Zv/Ministri i Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe zv/Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Halit Shamata.

Deri në sot Shqipëria nuk ka pasur një vështrim strategjik mjedisor të kompletuar dhe afatgjatë. Janë disa sektorë të mjedisit, të cilët kanë zhvilluar strategjitë pëkatëse, por të cilat nuk kanë qenë gjithëpërfshirëse. Shumë i mangët ka qenë integrimi i mjedisit në politikat e ndryshme sektoriale si: punët publike, transporti, energjika, planifikimi i territorit, arsini, bujqësia etj.

Ndaj SKM-ja si një strategji ndërvepruese muajt e ardhshëm do të integrohet me strategjitë e tjera sektoriale, për të zhvilluar kështu Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Për hartimin e SKM-së është analizuar fillimisht gjendja aktuale e mjedisit në zonat, ku ai ka probleme serioze, të cilat nuk pëmbushin standartet Evropiane. Ndërkohë është marrë në konsideratë Plani Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit dhe Plani i Veprimit për Bashkëpunimin Evropian si dhe strategjitë lokale të transportit, bujqësisë, energjisë dhe ato specifike të industrisë.

Duke ditur gjendjen e mjedisit, ai domosdoshmërisht ka nevojë për një program të mirëfilltë veprimi, i cili mund të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë së jetës, krijimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm dhe integrimin e strategjisë së mjedisit me strategjitë e tjera sektoriale.

Të tjerë objektiva, të cilat do të ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së mjedisit, të cilët u vlerësuan si shumë të rëndësishëm përgjatë konferencës ishin: përmirësimi i kuadrit ligjor, sigurimi i financimeve për mjedisin dhe rritja e informimit dhe pjesëmarrjes publike.

Bujana Xhindoli, QKE-AL



# OSBE-ja inicion projektin e radhës në mbrojtje të mjedisit

Projekti "Të Drejta të Dukshme", është një nga projektet që ka lançuar aktualisht OSBE-ja. Është një projekt i financuar nga Qeveria Franceze në bashkëpunim me OSBE-në. Projekti në fjalë fokusohet mbi të drejtën e

publikut për t'u informuar dhe konsiston në shpalljen e pëmbledhjeve të legjislativimit mbi të drejtën për informim të qytetarëve në zyrat e disa institucioneve të rëndësishme Shqiptare. Projekti përfshin gjithashtu zyrat e bashkive, prefekturave, si dhe

drejtoritë rajonale të disa prej institucioneve qendrore.

Pjesë e këtij projekti janë dhe zyrat rajonale të Ministrisë së Mjedisit ose ndryshe Agjencitë Rajonale të Mjedisit.

Me anë të afisheve që do të shpërndahen në shumë qytete të

Shqipërisë, publiku i gjerë do të ketë mundësi të marrë informacionin e duhur ashtu siç parashikohet dhe në Ligjin mbi të Drejtën e Informimit për Dokumentet Zyrtare të hartuar në qershor të vitit 1999. Përfaqësuesit e OSBE-së theksojnë se

shpallja në publik e këtij legjislativimi do të nriste besimin e publikut në institucionet shtetërore dhe nga ana tjetër do të nriste vetëdijën e zyrtarëve mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Ky projekt do të zbatohet nga Zyrat Rajonale të OSBE-se.



Vanessa Gosselin, Drejtuese e Zyrës Rajonale të OSBE-se në Vlorë, flet në intervistën e mëposhtme me gjësisht, merrkëtij projekti.

E dashuruar me natyrën shqiptare, sidomos pas bregdetit të mrekullueshëm të Sarandës dhe Vlorës ajo rrefen se ende s'ka mundur të vizitojë Alpet në veri të Shqipërisë. Midis të tjerave ajo shprehet se qytetarët shqiptarë edhe pse e adhurojnë natyrën e tyre ende nuk janë të ndërgjegjësuar për tu kujdesur për të.

"Shqipëria ka një "Vlerësim të Ndikimit Mjedisor" të UNEP-it, në të cilin evidentohen pikat e mëta të mjedisit, por ende nuk janë bërë përpjekje të mjaftueshme për zgjidhjen e këtyre problemeve mjedisore."

"Si fillim do donim të na tregonit diçka për veten tuaj, znj. Vanessa?"

"Emri im është Vanessa Gosselin. Unë jam lindur në Paris dhe jam qytetare Franceze."

Ure jam tridhjetë e dy vjeçe.

Ku jeni diplomuar dhe për çfarë?

Kam kryer studimet e larta për shkencë politike dhe në pas për filozofi politike në Britani.

-Sa kohë keni në Shqipëri?  
Në Shqipëri kam rreth një vit dhe punoj në Zyrën Rajonale të Vlorës. Në fillim kam punuar si oficer dhe thjeshtë mësa tani drejtoj këtë zyrë.

-Si ka lindur tek ju dëshira për tu marrë me çështjet mjedisore?

Më pëlqen shumë natyra për këtë arsye më pëlqen dhe të marram dhe me problemet e mjedisit. Por kam vënë re që në Vlorë ka shumë probleme mjedisore. Duke qenë se kam studiuar të drejtat e njeriut, jam interesuar në mënyrë të veçantë sesi çështjet mjedisore çojnë të drejtat e njeriut, jo vetëm për ndikimin ekonomik por dhe përsa i përket dëmtimit në shëndetin e tyre.

-Cila prej zonave natyrore të Shqipërisë ju ka lënë më tepër mbresa?

Deri tani nga natyra shqiptare më ka lënë më shumë mbresa vija bregdetare Vlorë-Sarandë. Por akoma nuk i kam vizituar Alpet në veri të Shqipërisë kështu që nuk dua të jap një vlerësim përfundimtar para kësaj.

-Përsa i përket angazhimit tuaj në OSBE dhe në pas kalimit në zyrën e OSBE-së këtu në Vlorë. Si ka ndodhur ky "uhëtim" juaji deri këtu? Ka qenë një dëshirë e juaja për të ardhur në Shqipëri apo kështu e deshni puna?

Është misioni i tretë që unë jam jashtë vendit tim, dhe e konsideroj veten me fat që kam pasur shansin të punoj në Azi, Afrikë dhe së fundi në Evropën Juglindore. Kjo qe arsyeja që më solli në Shqipëri dhe natyrisht kishte një vend të lire punë.

-Keni arritur të zhbironi në mentalitetin e njerëzve në Shqipëri përse i përket dëshirës së tyre ndaj natyrës? Ç'mund të na thoni në këtë pikë?

Mendoj se nuk ka një ndërgjegjësim të mjaftueshëm të qytetarëve shqiptarë për të mbrojtur mjedisin. Këtu kemi të bëjmë me dy aspekte: Së pari procesi i ndërtimit, i cili nuk ka kursyer as zonat turistike të vijës bregdetare; aspekti i dytë është menaxhimi i mbetjeve urbane. Nuk ka një përpjekje të mjaftueshme për mirë menaxhimin e këtyre mbetjeve por dhe angazhimi i qytetarëve për t'u marrë me të dëshinuar.

Megjithatë, pavarësisht këtyre, mendoj që qytetarët shqiptarë e duan shumë natyrën e tyre. Gjendja nuk është e paspresë por thjesht duhet pak kohë që qytetarët shqiptarë të bëhen të ndërgjegjshëm për mbrojtjen e natyrës.

-Çfarë parashikon konkretisht projekti "Të drejta të Dukshme"?

Projekti "Të Drejta të Dukshme", është një nga projektet që ka lançuar aktualisht OSBE-ja. Është një projekt i bashkë-financuar nga Qeveria Franceze në bashkëpunim me OSBE-në. Projekti në fjalë ka të bëjë me të drejtën e publikut për t'u informuar dhe konsiston në shpalljen e pëmbledhjeve të legjislativimit mbi të drejtën për informim të qytetarëve në zyrat e disa institucioneve të rëndësishme Shqiptare. Projekti gjithashtu përfshin zyrat e bashkive, prefekturave, si dhe drejtoritë rajonale të disa prej institucioneve qendrore.

Pjesë e këtij projekti janë dhe zyrat rajonale të Ministrisë së Mjedisit ose ndryshe Agjencitë Rajonale të Mjedisit.

Me anë të afisheve që do të shpërndahen në shumë qytete të Shqipërisë, publiku i gjerë do të ketë mundësi të marrë informacionin e duhur ashtu siç parashikohet dhe në

Ligjin mbi të Drejtën e Informimit për Dokumentet Zyrtare të hartuar në qershor të vitit 1999 dhe Konventën e Aarhusit. Shpallja në publik e këtij legjislativimi do të nriste besimin e publikut në institucionet shtetërore si dhe nga ana tjetër do i ndërgjegjësojë zyrtarët dhe qytetarët për të drejtat dhe detyrimet e tyre.

-Cilat janë institucionet shtetërore në Shqipëri që do të bashkëpunojnë për realizimin e këtij projekti?

Për realizimin e këtij projekti është kërkuar bashkëpunimi i një sere institucioneve qendrore si Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Prokuroria, Gjykatat, Ministria e Brendshme dhe Avokati i Popullit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave, Ministria e Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit si dhe Ministria e Mjedisit. Gjithashtu projekti parashikon afishimin e këtij lloji informacioni dhe në këshillat e qarqeve, prefektura dhe bashki.

-Çfarë shprehësimesh mjedisore ka vënë re Zyra e Vlorës në rajonin që ajo mbulon?

Shqipëria ka një "Vlerësim të Ndikimit në Mjedis" të vitit 2000, i cili është kryer nga Kombet e Bashkuara, (UNEP-i), Ky vlerësim identifikon disa pikat e mëta mjedisore të vendit. Zyra Rajonale e Vlorës nuk mbulon vetëm Vlorën por një numër rrethesh, Fierin, Vlorën, Lushnjën dhe Mallakastrën. Ka iniciativë për pikat e mëta mjedisore, por nuk janë bërë as përpjekje për t'u zgjidhur plotësisht. Duke analizuar, duket se mund të bëhet më tepër për të kultivuar komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet organizatave mjedisore dhe

autoriteteve për të gjetur zgjidhje për çështjet mjedisore.

-Cilat janë gjërat më me interes që kërkojnë një mënyrë të shpejtë, në përputhje me problematikën që është hasur?

Pikat e rrehta mjedisore, të identifikuar nga UNEP-i, që përfshihen në territorin që mbulon Zyra Rajonale e Vlorës janë: Rafineria në Ballsh, zona raftantabjësore e Patosit, Azotiku në Fier si dhe ish-fabrika e Sodës në Vlorë. Këto vazhdojnë të jenë zonat më problematike dhe që kërkojnë një mënyrë të shpejtë.

Në Vlorë ekziston Qendra për Shogërinë Civile, (QDSC). Si ka qenë niveli i bashkëpunimit tuaj me këtë qendër lidhur me problemet mjedisore?

QDSC-të që janë Qendrat e Zhvillimit të Shogërisë Civile, të shpërndara nëpër rrethe dhe natyrisht që bashkëpunojnë ngushtë me zyrat Rajonale të OSBE-së. Në rastin e Vlorës, ato janë të interesuara dhe të përfshira në çështjet mjedisore sepse vet shogëria civile e Vlorës është e interesuar për këtë çështje. Pra Qendra e Zhvillimit të Shogërisë Civile në Vlorë ka një rol kyç në shpërndarjen e informacionit mjedisor.

Në rrethet tuaj të projektit tuaj, a janë ftuar mediat për të luajtur rolin e tyre në informimin e publikut?

Mediat mendoj se do të jenë përfuturës dhe para nga ky projekt sepse mediat kërkojnë informacion nga institucionet shtetërore shumë më shpejt sesa publiku i thjeshtë. Është fjalë për një akses jo vetëm për mediat por dhe për shogërinë civile në përgjithësi për të parë impaktin e projekteve në mjedis.

## Prezenca e OSBE-së në Shqipëri nxit aktivitetet me rastin e "Ditës Botërore të Qyteteve të Pastra dhe pa Makina"

Qytete të pastra, një mjedis i shëndetshëm dhe një cilësi më e mirë e ajrit ishin qëllimet e një fushate ndërgjegjësimi publik, që u zhvillua me mbështetjen dhe financimin e Prezenës së OSBE-së në Shqipëri. Veprimtaritë të organizuara në muajin shtator të vitit 2005 dhe që u realizuan konkretisht në komunitet me moton "Së bashku për një Qytet të Pastër", u përkrahën nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU). Durrësi, Lushnja, Shkoder, Kruja, Kukësi dhe Vlora ishin qytetet kryesore pjesëmarrëse në fushatën e ndërmarrë nga OSBE-ja, në bashkëpunim me bashkitë përkatëse të tyre. Gjatë gjithë këtij tana të gjatë, programi sensibilizues ishte i përbashkët në mënyrë që të zhvillohej ashtu siç ishte parashikuar.

Programi përfshinte ndalimin e makinave në qendrat e qytetit për një periudhë kohë të përcaktuar, demonstrimin për banorët vendas të hedhjes në mënyrën e duhur të mbeturinave ndërsa në konkretisht ky program u realizua në Kukës ku u organizua një fushatë pastrimi e Liqenit

të Fierzës. Pjesë e veprimtarive sensibilizuese me rastin e 22 Shtatorit, ditës ndërkombëtare të qyteteve pa makina ishin edhe debatet televizive për çështjet mjedisore dhe shëtitje me biçikleta nga figura publike.



Zyra Rajonale në Vlorë, Kukës, Shkoder, si dhe Zyra Për Tiranën dhe Durrësin pranë Prezenës së OSBE-së ndihmuan në bashkëpunimin e përpjekjeve midis organizatave

joqeveritare vendore të përfshira në këtë projekt të iniciuar nga Klubi Ekologjik Lushnjë

Projekti synonte në rritjen e përpjekjeve të përbashkëta të komunitetit me qeverinë për

në 22 qershor 2005, u bë i mundur sigurimi i bazës materiale për shpërndarjen e 500 fletëgalosjeve, thirrjeve me anë të teksteve të ndryshme, shpërndarja e bluzave me logon "Të gjithë për një qytet më të pastër", organizimi i grave çiklistike të famijëve dhe të rinjve në qytetet pjesëmarrëse dhe shpërndarja e qumëve për fituesit, aktivitete që u njoftuan paraprakisht në media nëpërmjet spoteve televizive dhe bisedave në studio.

Aktivitetet synuan në promovimin e idesë së një qyteti të pastër dhe për rritjen e ndërgjegjësimit të njerëzve lidhur me rëndësinë e një mjedisi të shëndetshëm dhe rolin që çdo pjesëtar i komunitetit luan në mbrojtjen e tij.

Kështu, në qytetin e Durrësit, Bashkia e Durrësit dhe organizata joqeveritare "Natyrë e Qetë", në bashkëpunim me Qendrën për Zhvillimin e Shogërisë Civile - Durrës ishin partnerët vendorë të Prezenës së OSBE-së në organizimin e këtyre veprimtarive. Të gjitha aktivitetet u paraprinë nga një fushatë



# Lista e projekteve të OSBE-së në mbrojtje të mjedisit

Nr.	Lista e projekteve të OSBE-së në mbrojtje të mjedisit	Viti	Shuma në Euro		
			Budhetti e fonde të jashtme	Budhetti e fonde të brendshme	Budhetti e fonde të shtetit të prezencës
1	Hedhja e pengesave të rritjes ekonomike në zonat e varfra - përdorin i listatave fotovoltaike për sigurimin e ujit në Hyzgjokaj dhe Stavec, Lushnjë.	2003	22000		
2	Roli i qeverisë lokale në zbatimin e SKZHE-së, (Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social), faza e parë.	2003	4670		
3	Studimi i nevojave bazë të shtatë karburantëve agrikulorë.	2003			1840
4	Roli i qeverisë lokale në zbatimin e SKZHE-së, (faza e dytë).	2004	6000		
5	Mbrojtja e divarëve dekorativë në parkun e Lushnjës, faza e parë.	2004			945
6	Dokumentar televiziv për mbrojtjen e mjedisit dhe heqjen e mbetjeve industriale nga zonat e banuara në Shqipëri.	2004			1200
7	Fushatë ndërgjegjësuese mbi mjedisin lokal dhe mjedisin kombëtar për mjedisin lokal dhe mjedisin kombëtar.	2004-2005	9,670		
8	Projekti politik i paraveve diellore, (i instaluar në pëcat kryesore kuftare në Vesh, Muzinë, Hani i Hotit, Kapshticë, Blat, Kallmet, Lushnjë).	2005	45,000		
9	Prançat e lidhjes së qyteteve të pasura në Shqipëri.	2005			7,287
10	Kolekcionimi i heqjen e mbetjeve plastike dhe të ngurta për të përcaktuar uljen.	2005			2,500
11	Dhurimi i një sipërfaqeje Agjencisë Rajonale të Mbrojtjes së Mjedisit në Kullin.	2006		500	
12	Manuali për mbrojtjen e mjedisit të nivelit lokal.	2006		10,000	
	Mbështetje e qeverisë lokale në përfundimin e zbatimit të ligjit për parandalimin e ndotjesve mjedisore.	2006		10,000	
	<b>Shuma totale</b>		<b>121,612</b>	<b>20,500</b>	<b>13,772</b>

Kjo ishte lista e projekteve që OSBE-ja ka financuar për periudhën 2003-2006.

Projekti për heqjen e pengesave të rritjes ekonomike në zonat e

varfra - nëpërmjet përdorimit të sistemeve fotovoltaike për sigurimin e ujit në Hyzgjokaj dhe Stavec, Lushnjë, ka qenë projekti i OSBE-së i realizuar në vitin 2003


dhe ai i realizuar në vitin 2006 rri futjen e teknologjisë së paneleve diellore në pikat kufitare të Shqipërisë për të rritur kapacitetet e Policisë kanë qenë edhe projektet që kanë kushtuar më shumë gjatë këtyre viteve.

Projekt tjetër i OSBE-së i zbatuar po në vitin 2003 ka qenë dhe projekti rri rolin e qeverisë lokale në zbatimin e SKZHE-së, (Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social), për të cilin është shpenzuar një shumë prej 4670 euro. Po ashtu në listën e mësipërme janë shënuar dhe titujt e projekteve të tjera të organizuara nga OSBE-ja, viti i zbatimit të tyre si dhe shuma në euro e financuar për to. Pjesa më e madhe e këtyre projekteve janë zbatuar, mërsa përsa i përket projekteve të parashikuara për vitin 2006, një pjesë e tyre kanë përfunduar ndërsa të tjerët janë ende në proces zbatimi. Këtu mund të përmendim projektin e parashikuar prej OSBE-së për të mbështetur qeverinë lokale në përfundimin e ligjit për parandalimin e mbetjeve mjedisore, gjithashtu dhe projekte të tjera të cilat do të kanë të bëjnë me asistencën që parashikohet t'u ofrohet institucioneve vendore për menaxhimin e çështjeve mjedisore

në nivel lokal. Partneri kryesor në realizimin e këtyre projekteve ka qenë Ministria e Mjedisit. Partnerë

institucione të tjerë donatore për krijimin e Ministrisë së Mjedisit me qëllim ngritjen e çështjeve

Fondet e shpenzuara në vite nga Prezenca e OSBE në Shqipëri për projekte me komponentë mjedisore (në EURO) (Viti 2006 i referohet vetëm periudhës Janar-Qershor)




të tjerë të rëndësishëm në zbatimin e projekteve në Shqipëri kanë qenë REC, Qendra për Eficiençën e Energjisë, Klubet ekologjike, CSDC-të në rrethe dhe mjaft organizata dhe shoqata të tjera me fokus në çështjet mjedisore. Shuma totale e shpenzuar nga OSBE-ja gjatë këtyre viteve për projekte mjedisore arrin në shifrën e 121,612 euro.

Kontributi i OSBE në zgjidhjen e çështjeve mjedisore ka qenë i madh që në fillim të vendosjes së saj në Shqipëri, ku vlen të përmendet lobimi bashkë me

mjedisore në axhendën politike të qeverisë Shqiptare.

Numri i projekteve të ndërmarrja nga Prezenca e OSBE me komponentë mjedisore në vite (Viti 2006 i referohet vetëm periudhës Janar-Qershor)



Entela DURAJ  
Loreta KOXHAJ

## Dokumentari televiziv për mbrojtjen e mjedisit dhe domosdoshmërinë e largimit të mbetjeve industriale nga zonat e ndotura në Shqipëri

Duke ndjekur dhe trajtuar problemet mjedisore të Shqipërisë lidhur me degradimin e mjedisit dhe ekzistencën e një sasive të madhe mbetjesh industriale, që rrethojnë zonat e ndotura të vendit, si, Tirana, Elbasani, Fieri etj., në qershor të vitit 2004, Top Channel realizoi një dokumentar televiziv për çështjet mjedisore me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së dhe Ambasadës Britanike në Shqipëri, të transmetuar në programin televiziv "Jashtë Bulevardit".

Emisioni dokumentar i përgatitur me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Mjedisit, 5 Qershorit, u fokusua kryesisht në "Degradimin e mjedisit dhe nevojën për të larguar mbetjet industriale në Shqipëri", duke sjellë te publiku i gjerë rastet më goditëse në lidhje me pasojat e ndotjes së ajrit, degradimin e mjedisit në qytete dhe në periferi dhe duke i drejtuar problemet përkatëse drejt një perspektive për informimin e publikut.

Dokumentari televiziv tërhoqi vëmendjen e një audience të gjerë, jo vetëm sepse jepte informacionet e dhura dhe rriste vëmendjen rreth një çështjeje të veçantë shqetësuese në vend, por, gjithashtu, për

shkak të natyrës së veçantë të bashkëpunimit me organizatat e sipërpërmendura, që rezultoi në një mitje të vlerës për sa i përket cilësisë së pajisjes me informacion dhe mesazheve të përqara gjatë filmimit.

Në dokumentar u sollën fakte dhe të dhëna, të cilat ilustronin situatën e mjedisit në tri zonat e rrehta mjedisore, respektivisht në fushën e raftës në Ratos-Marinëz, ndotjen e ajrit në Tiranë nga djegia e mbeturinave në vendgrumbullimin e Stanës dhe kimikatet në Porto Romano. Gjithashtu, intervistat me banorët e atyre zonave, të prekur nga sëmundje të shkaktuara nga degradimi i mjedisit, e bënë më të prekshëm problemin e ndotjes për teleshikuesit.

Mesazhi i përçarur përmes transmetimit televiziv ishte që të rriste nivelin e informimit për vendimmarrësit në nivel lokal e qendror, si dhe të institucioneve përgjegjëse si, Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, sikurse edhe të vetë komunitetit për masat e menjëhershme që duhej të ndërmerreshin për të shpëtuar njerëzit nga rreziku i tokave shumë të ndotura në zona si Fieri, Durrësi dhe Tiranë.

RSK

## Manual për Menaxhimin e Çështjeve Mjedisore në Nivel Lokal

(Projekt në kuadrin e Refomës së Decentralizimit)

Zhvillimi i shpejtë social dhe ekonomik në Shqipëri ka shfaqur ndërlikime në menaxhimin lokal të mjedisit. Procesi i vendimmarrjes në nivel lokal është ende i natyrës nga lart-poshtë për faktin se dhe njohuritë në nivel lokal janë të kufizuara. Shqipëria ka miratuar Konventën e Aarhus-it në dhjetor, 2000. Zbatimi i detyrimeve të saj, për informimin mjedisor dhe pjesëmarrjen publike, është ende i kufizuar. Strategjia Kombëtare e Decentralizimit u kërkon autoriteteve lokale të kenë më tepër përgjegjësi në menaxhimin e burimeve natyrore lokale. Shumë bashki nuk i kanë dhënë rëndësi iniciativave mjedisore duke e konsideruar atë si një prioritet i nivelit të ulët. Problemet mjedisore urbane duhet të merren seriozisht në konsideratë nga vendimmarrësit, si përgjigje ndaj së drejtës së qytetarëve për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm.



Ky projekt i ndërmarrë nga Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (QSHKE) me mbështetjen e OSBE vjen si vijimi i një tjetër projekti të zbatuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri gjatë viteve 2004-2005 së bashku me Qendrën Rajonale të Mjedisit (REC) për promovimin e një pakete të re ligjesh mjedisore në strukturat e qeverisjes lokale.

Duke pasur parasysh situatën aktuale, objektivi kryesor i këtij projekti është forcimi i kapaciteteve të strukturave të nivelit lokal lidhur me çështjet mjedisore të tilla si menaxhimi i mbetjeve urbane, ndotjen e ajrit dhe të ujit në kuadrin

e Refomës së Decentralizimit.

Projekti do të konsistojë në ndihmesën e strukturave të qeverisjes vendore në 12 rajone të Shqipërisë, duke siguruar trajnime se si të trajtohen çështjet dhe problemet mjedisore në shqetësuese për nivelin lokal, në kuadrin e refomës së decentralizimit. Gjithashtu synohet prezantimi i praktikave dhe rasteve në të mira të menaxhimit mjedisor në nivel lokal, si guide për t'u zbatuar nga njësitë e qeverisjes vendore në kuadrin e refomës së decentralizimit. Raste dhe praktikat në të mira do të pëmbliken në një manual për t'u përdorur nga nëpunësit e trajnuar

të njësisve vendore si një guide e dobishme për menaxhimin e shqetësimeve mjedisore lokale.

Përfitues të këtij projekti janë ekspertët e qeverisjes vendore që kanë të bëjnë me çështjet mjedisore.

Projekti do të sigurojë një bashkëpunim me të mirë ndërmjet strukturave të qeverisjes vendore në zgjidhjen e problemeve mjedisore të zonës.

Projekti konsiston në dy faza. Faza e parë përfshin identifikimin dhe mbledhjen e informacionit rreth problemet mjedisore dhe praktikat në të mira për menaxhimin e tyre në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal. Kjo do të pasohet nga hartimi i një manuali rreth këto çështje.

Në fazën e dytë do të bëhet publikimi dhe shpërndarja e këtij manuali në të 12 qarqet, si dhe trajnimi i punonjësve të strukturave të qeverisjes lokale.

Për të arritur objektivat e sipërpërmendura, partnerët në zbatimin e këtij projekti po bëjnë identifikimin e shqetësimeve mjedisore në nivel lokal, shqyrtimin e strukturës ligjore shqiptare nga perspektivave të decentralizimit për të nxjerrë detyrimet e qeverisjes lokale në këtë aspekt dhe identifikimin e aftësive që i nevojiten stafit lokal për zgjidhjen e problemeve. Në mënyrë që të monitorohen përfitimet e aplikimit të praktikave në menaxhimin e burimeve natyrore, do të mbahen kontakte të vazhdueshme me strukturat lokale të përzgjedhura, si edhe me ekspertët e agjencive rajonale të mjedisit.

Rovena Tashi



# Përmirësimi i zbatimit të ligjit për parandalimin e ndotjes së mjedisit në nivel lokal

Tirana ka pasur një rritje të shpejtë të popullsisë gjatë këtyre viteve të fundit. Në 2005, prodhimi i mbeturinave të 600 000 banorëve ishte 0,8 kg për banor në ditë, mbeturina të cilat klasifikohen si mbeturina të ngurta urbane.

Brenda angazhimit në drejtim të një mjedisi të pastër, është bërë një hap përpara nga Bashkia e Tiranës, me hartimin e Strategjisë Lokale për një Mjedis të Shëndetshëm, për vitet 2005-2008.

Megjithatë, nuk ka një studim specifik mbi qëndrimin e publikut në drejtim të menaxhimit të mbetjeve në kryeqytet. Kjo mund të pohojë se sensibilizimi i publikut mbi rëndësinë e mbajtjes së një mjedisi të pastër është ende i ulët. Kjo duket qartë në hadhjen e mbeturinave jo në vendet e caktuara dhe në territoret e ndotura pranë zonave urbane.

Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit është miratuar nga Parlamenti shqiptar që në vitin 2002.

Ky është ligji i parë për mjedisin në vend, që përballlet me gamën e madhe të problemeve mjedisore. Bashkia e Tiranës, si një autoritet lokal është përgjegjëse për forcimin e zbatimit të ligjit brenda kufirit të shtrirjes së autoritetit të saj.

Autoriteteve lokale u mungojnë trajnimet e duhura për çështjet që lidhen me rregullat

mjedisore për të menaxhuar përgjegjësitë e tyre të reja në fushën e mjedisit. Trajtime të tilla mund të fillojnë me nëpunësit civilë që punojnë në Bashkinë e Tiranës.

Kështu lindi ideja e projektit të financuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, qëllimi i përgjithshëm i të cilit është të nrisë angazhimin e strukturave të bashkisë mbi përmirësimin e zbatimit të ligjit për parandalimin e ndotjes së mjedisit.

Ky projekt është tepër i rëndësishëm për qytetin e Tiranës dhe për banorët e saj, sepse synon të promovojë përmirësimin e kompetencave të strukturave të Bashkisë si, Policia Bashkiake, për të mbrojtur mjedisin; të promovojë vlerat e shoqërisë për një mjedis të pastër, si dhe të forcojë kompetencat ligjore të autoriteteve lokale për të zbatuar ligjin

për mbrojtjen e mjedisit.

Ky projekt ka filluar në maj të vitit 2006 dhe parashikohet të përfundojë në nëntor të vitit 2006. Partner zbatimi në këtë rast OSBE-ja ka Bashkinë e Tiranës dhe UNAA-në (Organizata e Kombeve të Bashkuara të Shqipërisë)

Projekti synon ngritjen e kapaciteteve të nëpunësve civilë

për një qytet të pastër, në përpjekje për t'i transmetuar këto rregulla për mbrojtjen e mjedisit të komuniteti i tyre. Si rrjedhim, projekti do të synojë të ketë një ndikim në praktikën e përditshme të punës së Bashkisë, duke marrë parasysh ligjet dhe rregulloret dhe duke reflektuar veprimet dhe qëndrimet e tyre në drejtim të

komunitetit përpunet me politikat e shprehura në statut.

Rritja e sensibilizimit për mjedisin konsiderohet nga ekspertët si një hap thelbësor në drejtim të aritjes së përmirësimit të mjedisit në të ardhmen. Edukimi mjedisor (në nivel shoqëror) përmendet si themelor për krijimin e bazës së ardhshme për përmirësimin dhe mbrojtjen e mjedisit.

Legjislativi, instrumentet ekonomike dhe mjetet e tjera nuk mund të jenë efektive kur publiku dhe vendimmarrësit, nuk i përkrahin hapet e tilla.

Suksesi i projektit do të bazohet në hartimin e një rregulloreje të re të brendshme të Bashkisë dhe përgatitjen e ekspertëve me trajnime të posaçme për ushtrimin sa më mirë të kompetencave të parashikuara në rregullore.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi janë: forcimi i kapaciteteve institucionale, përmirësimi i strukturës ligjore dhe forcimi i saj, parandalimi dhe lehtësimi i problemeve mjedisore, pjesëmarrja e publikut dhe komunitetit të biznesit në menaxhimin e qëndrueshëm të mjedisit.

Rovena Tashi



në strukturat e bashkisë të angazhuar me probleme të mbrojtjes së mjedisit, të cilët do të kontribuojnë për një menaxhim më të mirë të mbeturinave urbane

komunitetit, dhe në veçanti, në përmirësimin kuadrit rregullator.

Përmirësimi i zbatimit të ligjit mbi mjedisin është thelbësor për të garantuar që përshtatja e

# Ruajtja, mbrojtja dhe gjelbërimi i mjedisit në Parkun e Madh të Liqenit Artificial të Tiranës

Në kuadrin e aktiviteteve për sensibilizimin e opinionit publik për mbrojtjen e mjedisit, në majin mars 2004, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri mbështeti një projekt për shtimin e sipërfaqeve të gjelbra të mbjella me drurë për banorët e Tiranës, që synonte në mënyrë të veçantë, mbrojtjen e biodiversitetit të Parkut të Liqenit të Tiranës.

Klubi Ekologjik Tirana ka qenë partner në zbatimin e këtij projekti, duke organizuar mbjelljen e pemëve dekorative, në bashkëpunim me ndërmarrjen e Gjelbërimit të Bashkisë së Tiranës, si dhe duke aktivizuar disa grupe të rinjsh ambientalistë të shkollave të tërëvjeçare dhe të mesme të Tiranës.

Projekti kishte si qëllim edukimin mjedisor të komunitetit, kryesisht të të rinjve të shkollave pjesëmarrëse në projekt, duke rritur ndërgjegjësimin e tyre për rolin që kanë dhe mund të luajnë për mbrojtjen e mjedisit, dhe konkretisht në mbrojtjen dhe shtimin e pemëve. Aktivitetet e projektit përfshinë

dy faza. Faza e parë, bashkëbisedimi mes ambientalistëve të shkollave të tërëvjeçare dhe Shërbimit Pyjor, në



kuadrin e majit të pyllëzimit dhe faza e dytë, mbjellja e fidanëve nga Klubi Ekologjik dhe grupet mjedisore të shkollave të Tiranës.

Fillimi i projektit u shoqërua me një ceremoni të organizuar më 4 mars 2004, në mjediset e Shkollës së Kuqe,

ku ishin të pranishëm anëtarë të Klubit Ekologjik, përfaqësues të Prezençës së OSBE-së në Shqipëri,

si dhe përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit dhe të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor. Njësinë të shkollave 8-vjeçare "Kushtrimi i Lirisë", "Qazim Turdiu", "Lidhja e Prizrenit", "Shkolla e Kuqe" dhe të shkollave të mesme "Çajupi", "Hoteleri-Turizëm", si dhe të Shtëpisë së Fëmijës "Zyber Hallulli", përveç pjesëmarrjes aktive në këtë takim, organizuan edhe një koncert festiv, si dhe mbollën 4 mënjë mirmoze, dhuratë nga projekti.

Gjatë fazës së dytë të projektit u organizua mbjellja e drurëve dekorativë nga mënësit e shkollave 8-vjeçare të Tiranës. Bashkëpunuese në këtë projekt të mbështetur nga OSBE, ishte dhe Ndërmarrja e Gjelbërimit të Bashkisë së Tiranës. Për mbjelljen e 36 mënjëve të drurëve dekorativë si pisha, manjola, ullinj etj., u angazhuan mënësit e shkollave pjesëmarrëse në takim, ndërsa grupat u hapën nga punonjësit e Ndërmarrjes së Gjelbërimit të Bashkisë Tiranë. Në këtë takim mori

pjesë dhe vetë kryetari i atëhershëm i Prezençës së OSBE-së në Tiranë, ambasadori Osmo Liponen. E veçanta në këtë veprimtari ishte praninë e mënësve të Shtëpisë së Fëmijëve "Zyber Hallulli". Në përfundim të ceremonisë së mbjelljes së pemëve, nën moton "Një pemë-një jetë", Prezenca e OSBE-së i dhuroi Shtëpisë së Fëmijëve 10 drurë dekorativë, 8 vegla pure, si dhe 4 kova për mbjelljen e drurëve dekorativë. Ceremonia e mbjelljes së pemëve u hap nga vetë ambasadori i OSBE-së, i cili mbollti një ulli, pemë që simbolizon paqen. Më pas, i gjithë aktiviteti vazhdoi me mbjelljen e pemëve, që angazhoi gjithë mënësit e shkollave 8-vjeçare të Tiranës. Në fund të takimit, mënësve të shkollave iu shpërndanë bluza dhe kapele të bardha me logot e OSBE-së dhe të Klubit Ekologjik Tirana. Ky aktivitet pati një mbulim të gjerë në median televizive dhe atë të shkruar.

L. KOXHAJ

# Dora e ngrohtë e Europës

(Vijon nga faqja 1)

në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Njerëzit me Afërsi të Kufizuar. Në nivel lokal, Prezenca mbështet Qendrat e Zhvillimit të Shoqërisë Civile, të cilat trajtojnë dhe ndihmojnë organizatat e shoqërisë civile. Këto qendra ndodhen në Durrës, Elbasan, Korçë, Vlorë, Shkodër dhe Kukës. Ato kanë për qëllim të forcojnë kapacitetin e shoqërisë civile lokale për të mbikëqyrur punën e autoriteteve, për të ndihmuar në rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe për të pasur shërbime publike më të mira, një mbrojtje më të madhe të mjedisit, si dhe në shumë

të drejta për gratë dhe personat me afërsi të kufizuar. Qëllimi i Prezençës është që këto qendra, të cilat janë regjistruar si persona juridikë, të arrijnë pavarësinë e tyre vepruese dhe menaxhuese. Në bashkëpunim me Qeverinë dhe si aktorë të Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin Social-Ekonomik, Prezenca ndihmon në zhvillimin e reformave sociale dhe ekonomike. Ajo promovon integrimin e aktorëve vendorë në procesin e zhvillimit social dhe ekonomik dhe ndihmon në trajtimin e shkaqeve që çojnë në veprimtari të paligjshme, si trafikimi dhe migrimi i paligjshëm.

Gjithashtu, Prezenca mbështet ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor, duke u përqendruar tek të rinjtë dhe gratë. Duke punuar me qeverinë qendrore e lokale dhe organizatat të tjera ndërkombëtare dhe vendase, Prezenca ndihmon për rritjen e ndërgjegjësimin mes të rinjve për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit. Së bashku me organizata joqeveritare që promovojnë transparencën, mirëqeverisjen dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale, ajo ndërmerr e menaxhon projekte që synojnë posaçërisht këto grupe. Gjithashtu,

Prezenca siguron ndihmesë në procesin e reformës administrative territoriale dhe asaj të decentralizimit. Bashkë me ODIHR-in dhe zyrën e Koordinatorit të Veprimtarive të OSBE-së në fushën e Ekonomisë dhe Mjedisit, Prezenca po zbaton një program për të promovuar fuqizimin ekonomik dhe asistencën ligjore si mjete për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore. Ky program është një fazë pasuese e projektit të suksesshëm të Edukimit për të Drejtat e Grave dhe Anti-Trafikimit, zbatuar në periudhën 2000-2004, i cili synonte të sensibilizonte grupet e syn-

uara për të drejtat e grave dhe për të rritur ndërgjegjësimin e shtresave më të rrezikuara nga dhuna në familje dhe trafikimi. Gjithashtu, Prezenca merr pjesë në programin e Bashkimit Evropian të Asistencës së Komunitetit për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim (CARDS), i cili ka filluar në vitin 2003, për përzgjedhjen e viktimitave të trafikimit, azilkerkuesve dhe migrantëve. Ky projekt realizohet në bashkëpunim me Qeverinë shqiptare, Komisionerin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR) dhe Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM).



# Falenderim i ambjentalisit



Të falen ty Botëror i Futbollit!  
Atë që dot s'ma jepte kush, as Kuvendi me votimin e ligjeve, as Qeveria me ekzekutimin e tyre, as Presidenca me dekretimet, as policia, as masmedia, as OJQ-të... askush, askush, pona jep ti.

Qëkurse fillove ti më tetë qershor, mugët tona të stërlohuara marrin më në fund pak frymë lirshëm, bylyku i automjeteve nbi to është rulluar disi, për rrjedhojë edhe ajrin e kami më pak të rrotur, edhe zhumat më pak të padurueshme, edhe udhëtimin urban më pak të ngjeshur. Vërtet që dëgjohen hera-herës thirrmat goool! që shpërthejnë nga dritaret e shtëpive dhe të bareve, por kjo bie si muzikë në veshët tanë të çarë nga gulçimat e makinave. Madje kjo thirrme ngazëlluese ka

trembur dhe mpakur edhe të kërtiturat çjenëse në baret dhe pub-et e pronarëve veshëtrashë shqiptarë. Një hije mirësie, paqje e harmonie ka rënë nbi fytyrat dhe gjestet e njerëze, e cila sikur i ngjitet edhe mjedisit përreth.

Të falen ty Botëror i Futbollit!  
Shunë janë përpjekur ambjentalistët e botës për të fituar një ditë - 22 shtatorin e qyteteve pa makina - dhe mezi i kanë shkëputur kësaj dite disapak minuta. Erde ti dhe na fale jo një, por sa e sa 22 shtatorë, (më saktë mbasdite e mbërmeje 22 shtatori).

Të falen ty lojë magjike, ty top i bardhë që tundon për gjuajtje këmbët e të gjithë njerëzve, ty fushë e blertë që gëzon syrin e miliardë njerëzve!  
Ty fushë e blertë!

Bardho Dreri

## OPINION

# Gjyqi i mbrapshtë i plehërave



Më 10 korrik gjykata e Tiranës dënoi z. Koço Kokëdhima me gjobën prej 4 milionë lekësh për fytyrë të dinjitetit të firmës italiane "Albania Beg". Çështja aq e përfolur dhe e kundërshtuar e importimit të plehërave italiane u rihap në seancë gjyqësore vetëm për disa minuta të cilat mjaftuan për të lëshuar kutërbimin e mallit dhe të marrëveshjes së qeverisë së kaluar me firmën e sipërpërmendur. Këtë erë të rrotur na e përcolli në mënyrë të dendësuar vetë vendimi i gjykatës.

Veshët e imunizuar të shqiptarëve kanë dëgjuar kaq shunë qutira dhe paudhësira, saqë janë aftësuar më së miri për të qerë rafrektorë e për ta kaluar tutje lajmin e paudhë duke i vënë shpejt e shpejt etiketën "quti e radhës". Por qutia e kësaj radhe e meriton të dalë në kryeradhë.

Vendimi i gjykatës së tiranës për të ndëshkuar z. Kokëdhima, president i "ZK group", është i mbrapshtë nga të gjitha pikëpamjet. As në pak as në shunë ai mëshkon fjalën e lirë dhe të drejtat themelore të qytetarit shqiptar, ndëshkon guximin qytetar për të denoncuar një të keqe shoqërore, dënohet përkushtimi dhe sakrifica për t'i

shërbyer vendit dhe popullit, goditet mërgjegjja dhe lëvizja jonë mjedisore ende e brishtë. Për vetë pozitën ekonomike dhe mjetet mediatike që zotëron z. Kokëdhima, botuesi i mirënjohur i "Shkulli-t", u rrodh në qendër të protestave komunitare përkrah shumë intelektualëve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile. Rrjedhimisht dhe në fitoren e arritur ndaj kundërshtarëve aq të fuqishëm me portofol deri dhe kryeministrot, ai ka meritat të veçanta. Prandaj dhe firma italiane e plehërave (nuk dinë nëse edhe

pëson si z. Koço Kokëdhima; përkushtimi qytetar, patriotizmi dhe të tjerë dikra si këto nuk vlejnë një lek. Prandaj vërtet gishtin kokës". Dëmi që bë do të paguante botuesi i "Shkulli-t" do të ishte 4 milionë, dëmi që i shkaktohet moralit shoqëror është i pallogaritshëm. E drejta qhet e shtrenjtë, e vërteta- gënjeshtër, mbarësia - e mbrapshtë, guximi qytetar- marrëzi, shërbimi ndaj komunitetit- pa pikë vlere, me një fjalë, e mira paditet si e keqe. Natyrisht trupi gjykues mund të rrahirë tërë ato arsye teknike që e



në marrëveshje me palën shqiptare) paditi pikërisht atë. Teksti i vendimit të gjykatës është: Duke vlerësuar shikuesmërinë e televizionit dhe ndikimin e tij në publik, Z. Koço Kokëdhima gjobitet me katër milionë lekë për dëmin që i ka shkaktuar shoqërisë "Albania Beg". Nënteksti është: Kush guxon të denoncojë një nënëveshje qeveritare, qoftë kjo edhe e fishhtë dhe kriminale, e

shtërguan të merite një vendim të tillë, porse ka një gjykim opinionori që e kapëron çdo gjykatë. Dhe në këtë rast morali i shoqërisë, i ambientalistëve, i përfaqësuesve të shoqërisë civile është i tëri në anën e të ndëshkuarit. Prandaj i takon gjykatës së Apelit ta shfuqizojë sa më parë këtë vendim anomal, për t'i kthyer dinjitetin në radhë të parë vetvetes.

Kastriot Mahilaj

# Dita botërore e popullsisë dhe problemet që prekin Shqipërinë

Këtë vit vëmendja e Ditës Botërore të Popullsisë është drejtuar tek të rinjtë.

Në deklaratën e saj drejtorja ekzekutive e Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA), Thoaya Obaid, theksoi se të rinjtë në të gjithë botën duan të jenë të fortë dhe të angazhuar. Ata zotërojnë ide, vendosmëri dhe energji për të përsheptuar veprime efektive për uljen e varfërisë dhe pabarazisë. Është e qartë që qëllimet e zhvillimit të mijëvjeçarit nuk do të mund të arrihen derisa të rinjtë të angazhohen në bërjen e politikave dhe programeve, zërat e tyre të dëgjohen, nevojat e tyre të plotësohen dhe të drejtat e tyre të respektohen.

Tetë qëllimet e zhvillimit të mijëvjeçarit, duke filluar që nga përgjysmimi i varfërisë tek parandalimi i përhapjes së HIV/AIDS-it dhe sigurimi i një edukimi parësor të gjithanshëm, brenda afatit përfundimtar të 2015, janë synimet e një projekti të miratuar nga të gjitha vendet dhe institucionet kryesore për zhvillim në botë. Ato kanë nxitur përpjekje të pashembullta për të plotësuar nevojat e pjesës më të varfër të botës.



Pse u drejtohet të rinjve?  
• Gjysma e njerëzve në botë janë nbi moshën 25 vjeçare. Në 57 vende në zhvillim nbi 40% e popullsisë është nën 15 vjeç.  
• 22% e të rinjve në të gjithë botën jeton me më pak se një dollar në ditë.  
• 82 milionë vajza në vendet në zhvillim, që janë tani nga 10-17 vjeç, do të martohen përpara se të mbushin të tetëmbëdhjetat.  
• Sigurimi i të drejtës universale në shëndetin riprodhues, përfshirë planifikimin familjar është një pikënisje për një të ardhme më të mirë për 1.5 miliardë të rinj që jetojnë në vendet në zhvillim.  
• sot miliona të rinj kërcëohen nga varfëria, analfabetizimi, mrezizot e shtatzënisë dhe lindjes së fëmijës si dhe HIV/AIDS

Dhe situata që prek realitetin shqiptar nuk është më pak alarmante, duke pasur parasysh se jemi një nga vendet në zhvillim të botës së tretë dhe ndër vendet me standard jetese dhe të ardhura më të ulëta.

Programi i parë për vendin tonë fokusohet në kujdesin ndaj nënës dhe fëmijës, shëndetin seksual dhe riprodhues dhe në mënyrë të veçantë në parandalimin dhe reduktimin e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme (SSI) tek të rinjtë.

Bazazia dhe drejtësia gjinore, fuqizimi i grave, eliminimi i të gjithë llojeve të dhunës ndaj tyre dhe sigurimi i mundësisë për të kontrolluar fertilitetin e tyre janë hapat bazë të programeve të popullsisë dhe zhvillimit.

Një nga aktivitetet e zhvilluara këtë vit në Shqipëri me rastin e Ditës Botërore të Popullsisë nga (UNFPA) në bashkëpunim me organizatën "Young Europeans for Security Albania" ishte organizimi i një karvani sensibilizues që nisi nga Tirana për në Fushë Krujë, Maruzas, Lezhë dhe Shëngjin, ku u zhvilluan takime me të rinj nga zonat rurale dhe periferitë e qyteteve dhe u shpërndanë e materialeve me informacione në lidhje me Ditën Botërore të Popullsisë. Shunë të rinj patën mundësinë të informohen dhe të marrin njohuri nbi HIV/AIDS dhe mënyrat e mirënjohjes nëpërmjet shpërndarjes së broshurave informuese.

Mëshkruar në të drënat e Institutit të Shëndetit Publik, nga 2 të infektuar në 1993 numri i tyre kap shifrën e 179 personave në 2005 (129 meshkuj dhe 50 femra), ndër të cilët 11 raste të të infektuarve janë fëmijë. Por, duhet të

kemi parasysh edhe faktin që këto janë vetëm shifrat zyrtare dhe ekziston mundësia e moskonstatimit të shumë rasteve të tjera reale. Gjumshat në të prekurat janë ato nga 20 deri në 35 vjeç dhe Tirana ka numrin më të lartë të të infektuarve, me 18 raste të konstatuara.

Po sipas statistikave të IHP-së, rreth 40 mijë fëmijë lindin çdo vit. Por ajo që tingëllon më alarmante për UNFPA është fakti se shtatzënia në moshat e reja, sidomos tek ableshentët, llogaritet sipas INSTAT në 16.6% të të gjitha lindjeve. Metodat parandaluese të shtatzënisë nuk njihen sa duhet dhe përdoren vetëm në 11% të rasteve.



Jetëgjatësia mesatare e jetës në vendin tonë është 73.8 vjeç, 72 vjeç për burat dhe 77 për gratë (sipas të dhënave të "Raportit për Zhvillimin Njerëzor" të PNUI-it, 2005), ku theksohet edhe diçka tjetër alarmante për shëkullin në të cilin jetojmë: rreth 1.3% e popullsisë është analfabete.

Dita Botërore e Popullsisë festohet nga UNFPA-ja në të gjithë botën çdo vit në 11 Korrik. Sloganet e ndryshme të viteve të fundit kanë qerë "Marrni jetën e graas", "Popullsia, zhvillimi dhe ambienti" dhe "Varfëria, popullsia dhe

zhvillimi".

UNFPA filloi të qerojë në 1969. Ky fond i ofron asistencë vendeve në zhvillim, vendeve me ekonomi në tranzicion dhe vendeve të tjera sipas kërkesës së tyre, për t'i ndihmuar ato në zgjidhjen e problemeve nbi popullsinë, duke përfshirë shëndetin riprodhues.

Zhvillimi me ritme të shpejta i popullsisë është një problem me rëndësi globale. Rritja e popullsisë ushtron trazyni ndaj burimeve natyrore dhe ambientit, duke frenuar kështu zhvillimin e përgjithshëm dhe duke përkeqësuar cilësinë e jetës për të gjithë.

Sfidat e së sotmes është përmirësimi i cilësisë së jetës për popullsinë në mritje pa e shkatëruar ambientin, duke qar kështu drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

"Ne do të kemi kohë të arrijmë qëllimet e zhvillimit të mijëvjeçarit, në shkallë botërore ose në vende individuale, por vetëm nëse e nisim këtë biznes siç duhet. Nuk mund të fitojmë brenda një nate. Suksesi kërkon një aksion të pandërprerë gjatë gjithë dhjetëvjeçarit deri në afatin përfundimtar. Kjo kërkon kohë për trajnimin e mësuesve, infermierëve dhe inzhinierëve për të ndërtuar rrugë, shkolla dhe spitale, për të zhvilluar bizneset e vogla dhe të mëdha në mënyrë që të krijojnë mundësi punësimi dhe të ardhurat e nevojshme. Pra, me mund të fillojmë tani. Dhe kemi nevojë për më shumë se dyfishin e përkrahjes për zhvillim global gjatë viteve në vazhdim. Aqgjë më pak se kaq s'mund të ndihmojë në arritjen e qëllimeve", - ky ishte mesazhi i sekretarit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Kofi A. Annan, me rastin e ditës botërore të popullsisë.

Rovena TASHI



# Varfëria dhe mjedisi

Rreth 3 miliardë njerëz (gjysma e popullsisë globale) jetojnë me më pak se 2 euro në ditë.

Lidhjet midis varfërisë dhe mjedisit janë komplekse dhe shpesh bëhen shkas për keqkuptime.

Titujt mbresëlënës si: "Varfëria është ndotje" dhe "Mjedi i shëndetshëm, njerëz të suksesshëm" janë mashtrues: ata përgjithësojnë marrëdhëniet e ndërlikuara ndërmjet varfërisë dhe mungesës së menaxhimit të burimeve dhe harrojnë të thonë se degradimi i mjedisit është një pasojë e përvitësme e rritjes ekonomike, që udhëhiqet kryesisht nga interesa komerciale dhe është shkak kryesor i varfërisë.


Mjedi është veçanërisht i rëndësishëm për njerëzit e varfër. Të shëndetshmit përbëjnë vetëm 20% të popullsisë së botës, por ata konsumojnë 70-80% të burimeve të saj: shumë politika institucionale favorizojnë të shëndetshmit me shpenzimet e të varfërve.

P.sh., subvencionet që favorizojnë të ardhurat e konsumatorëve të mesëm dhe të lartë janë duke dëmtuar në veçanti të varfrit, duke qenë se ata tejpërdorin burime natyrore të rëndësishme dhe degradojnë tokën, nga e cila varen të varfrit. Ky degradim mund të shkaktojë ulje të pjellorisë së tokës, shpërgulje dhe edukim të pamjaftueshëm (fëmijët mund të lenë shkollën për të ndihmuar familjet).

Këto marrëdhënie varen nga një shumëllojshmëri faktorësh:

- Të varfrit mbështeten tek mjedisi për ekzistencë dhe punësim. Më të varfrit zakonisht janë punëtorë pa tokë, që varen nga toka, peshku dhe burime të tjera natyrore. Por, kompani dhe shtete të mëdha, të cilët plotësojnë nevojat e konsumatorëve në qendra urbane dhe industriale, shpesh u mohojnë të varfërve të drejtën mbi këto burime ose lejojnë që këto burime të degradohen.

- Të varfrit janë më të prirur të ekspozohen ndaj ujit dhe ajrit të ndotur, që



shkaktojnë sëmundje dhe vdekje të parakohshme. Shumë njerëz të varfër jetojnë në ose pranë fabrikave që

ndotin ujin dhe ajrin. Sëmundjet i largojnë shpesh njerëzit nga vendet e punës për periudha të gjata dhe,

madje, mund t'i çojnë deri në vdekje. Infeksionet në muqet e frymëmarrjes dhe sëmundjet e transmetuara nga uji janë një ndër shkaqet më të mëdha të vdekjeve tek këta njerëz.

- Njerëzit e varfër janë më të rrezikuar nga katastrofat mjedisore dhe ndryshimet klimatike. Ata vuajnë më shumë humbje, padrejtësi dhe vdekje nga katastrofat natyrore se pjesa tjetër e popullsisë, duke qenë se ata janë në të prirur të jetojnë në shtëpi të pasigurta dhe zona të prirura për katastrofa natyrore. P.sh., në 1992, në Bangladesh një ciklon shkaktoi 100 000 të vdekur, në krahasim me 32 nga një ciklon i së njëjtës pëmasë në SHBA.

- Të varfrit kanë të drejtë të keqpërcaktuar toke. Nëse do të kishin të drejtë mbajtjeje të tokës, askush s'do mund t'i largonte këta njerëz, që kanë treguar përkujdesje për burimet natyrore, nga tokat ku jetojnë. E drejta e informacionit dhe teknologjia, gjithashtu mund t'u sigurojë atyre tokën dhe burimet natyrore, tek të cilat ata mbështeten.

Rovena Tashi

# Alternativat e gjelbra

Energjia e përtëritshme mund të ndihmojë si mjedisin, ashtu edhe varfërinë. Në shumë vende në zhvillim, kostoja e shpërndarjes së energjisë elektrike deri në fshatra është shumë e lartë dhe është e varur nga lëndët djegëse fosile. Por energjia e rinovueshme mund të plotësojë nevojat për energji, riciklon të ardhurat dhe krijon vende pune lokale, për shkak të rrjetit të shkurtër të shpërndarjes. Si pasojë rritja e investimeve në rajon ul migrimin drejt qyteteve.

Energjia diellore mund të pëmbushë në të ardhmen nevojat për energji në vendet dhe të sigurojë një burim të rëndësishëm të ardhurash, nëpërmjet eksportit dhe konsumit lokal.

Shumë vende i kanë përdorur me sukses bujqësinë organike dhe pyjet e qëndrueshme për të ulur varfërinë. Në Kili, kulturat ujore të eskallopit kanë krijuar mundësi punësimi dhe kanë rritur biodiversitetin

Ka shumë mënyra për të përmirësuar mjedisin dhe ulur varfërinë.

Këto përfshijnë zhvillimin e energjisë së qëndrueshme dhe mbështetjen e bujqësisë organike. Kujdesi për mjedisin shkon krah për krah me uljen e varfërisë. Alternativat e gjelbra mund të krijojnë mundësi punësimi dhe të riciklojnë paratë në vendet me të ardhura të ulëta.



dëtar. Në Amazonë, rritja e qëndrueshme e plantacioneve të palmave ka parandaluar shpyllëzimin.

Shumë komunitete të varfra kanë natyrë turistike, por po të planifikohet mirë, ekoturizmi, mund të ruajë mjedisin dhe, njëkohësisht të krijojë mundësi për komunitetin.

Ekoturizmi kërkon një strategji afatgjatë: monitorim të kujdesshëm, vlerësim dhe parandalim të dëmeve të ekosistemeve nga vizitorët, në mënyrë që të sigurojë që shpenzimet e turistëve të forcojnë ekonominë lokale.

Përpjekjet për të kontrolluar binët pushtuese, të huaja, kanë ndihmuar në krijimin e vendeve të punës dhe përmirësimin e mjedisit. Në Afrikë, programi "Working for Water" ka patur sukses në uljen e ndikimit të specieve aliene në cilësinë e ujit dhe në hapjen e mundësive të punësimit.

Rovi SHENA



## Shkurt nga bota

### ÇFARË ËSHTË ENERGJIA DIELLORE?

Gjatë shpërndarimit të Hidrogjenit në Helium, dielli lëshon energji rezatuese (fuzioni atomik bërthamor). Kjo energji përbëhet prej dritës (e dukshme) dhe ngritësia (rezatim



i padukshëm) të cilat janë të gatshme për përdorim. Pa këtë energji nuk do të mund të ekzistonte asnjë shenjë jete në tokë. Dielli rezaton në tokë, në një orë, në shumë energji se sa hapton gjithë popullsinë e tokës në një vit.

Si mund të përdoret energjia diellore?

Energjia diellore mund të përdoret direkt ose indirekt. Në përgjithësi bëjnë dallim në mënyrën e përdorimit për krijim ngritësia (solartermik) dhe përdorimit për energji elektrike (fotovoltaik). Këto janë teknika të ndryshme. Instalimet solartermike përbëhen zakonisht nga një mbledhës (kolektor) diellor dhe prej një depoje për ujë të ngritë. Mbledhësi kthen dritën në ngritësi, e cila i përcillet depos së ujit. Uji i ngritë i depozituar shërben për dush ose larje; ndihmohet gjithashtu edhe nga sistemi ngritjes së shtëpisë.

Sistemet fotovoltaike prodhojnë rrymë elektrike. Drita e diellit shpërndahet nga qelizat diellore në rrymë të vazhduar, e cila ose depozitohet në bateri ose kthehet në rrymë të alternuar me anë të një ndryshuesi rryme. Kjo rrymë alternative mund të përdoret direkt në shtëpi ose të furnizojë rrjetin.

Me përdorim pasiv të energjisë diellore kuptojmë përdorimin e rrezeve diellore nëpërmjet sipërfaqeve të dritareve, për të kursyer energji për ngrohje. Për këtë arsye, një përdorim i dobishëm i dritareve është një synim i rëndësishëm.

Çfarë dobie ka një instalim diellor për ambientin?

Energjia diellore zëvendëson prodhuesit e tjerë të energjisë (raftë, gaz, qymyr, uran) dhe pakëson ndotjen e ambientit me "jashtëqitjen" e gazit karbnik (efekti serë) dhe nga gaze të tjerë (p.sh shiu acid). Në krahasim me hapshimin e energjisë elektrike për ujë të ngritë, mundet një sistem solartermik 6 m i madh, të kursejë çdo vit deri në 1.500 kg CO. Një sistem fotovoltaik me një fuqi prej 2 kë kursen çdo vit deri në 1.200 kg CO. Pra lëndë të quara të tokës, mbeten kështu edhe në të ardhmen për qëllime në të mira se sa thjesht djegia e tyre. Duke qenë burime jo

## GRUPIMI "EKOLËVIZJA"

- Shoqata e Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Mjedisit Natyror, Shkodër - Fatbardh Sokoli
- Shoqata e Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Mjedisit Natyror, Tiranë - Pranvera Bekteshi
- Shoqata Kriboçtare progresi pyjor - Tiranë, Liljana Shehu
- Albaforest, Tiranë, Mehmet Meta
- Qendra Eden, Tiranë - Merita Mansaku
- Klubi Ekologjik, Krujë - Miharrem Goci
- Shoqata e Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Mjedisit Natyror, Berat - Genta Decolli
- Liliun Albanicum, Librazhd - Ferit Hysa
- Masmmedia dhe Mjedisi - Xhemal Mato
- Qendra për Komunikimin Elektronik, Tiranë - Ladi Balla
- Qendra Kriboçtare e Lëvizjes Ambientaliste, Tiranë - Haziz Marku
- Klubi Ekologjik, Elbasan - Ahmet Mehmeti
- Instituti i Studimeve të Ambientit, Tiranë - Agron Deliu
- Laguna e Kaltër, Orikum - Skënder Mejdiaj
- Klubi Ekologjik, Librazhd - Naim Disani
- Shoqata Pylli i Blertë - Buçimas, Pogradec - Ruzhdi Hymetllari
- Milieukontakt Oost Europa, Tiranë - Vallbona Mazreku
- Shoqata e Përmakulturës, Tiranë - Edlira Mulla
- Klubi Ekologjik, Tiranë - Fatos Xhemalaj
- G&G Group, Tiranë - Sazan Guri
- AULEDA, Vlorë - Hasan Hallko
- Shoqata Mjedisi Ekologjik dhe Turistik Lura, Lurë - Ismail Hysa
- Shoqata kriboçtare e gjuetarëve dhe peshkatarëve sportivë të Shqipërisë, Tiranë - Themil Peni
- Qendra e konsulentëve veterinarë dhe sigurisë ushqimore, Tiranë - Gani Moka
- Klubi Ekologjik, Maliq - Myzafer Gjirriti
- Shoqata "Natyra për njeriun", Durrës - Fali Ndreka

## Shkurt nga bota

të përqendruara energjive ulen ndjeshëm si shpenzimet ashtu edhe rrezigjet e transportit (cisterna raftë, transporte radioaktive).

### BIEN FITIMET E KONTRABANDËS SË SKIFTERËVE, ZOGJTË RREZIKOJNË ZHDUKJEN

Kontrabanda po çon shumë specie të skifterit drejt zhdukjes në një treg të paligjshëm, ku çmimet e zogjve mund të shkojnë në një milion \$ për secilin.

Tregu i zi i zogjve grabitqarë, i përqendruar rreth Lindjes së Mesme dhe Azisë Qendrore, mund të japë të ardhura më të mëdha sesa shitja e drogave apo amëve.

Përfytyroni të keni diçka që peshon rreth 1 kg në dorën tuaj, e cila mund të shitet për një milion \$. Vlerësohet se kontrabanda e grabitqarëve në 2001 arriti në 14 000 zogj, duke filluar nga shqiponjat e deri tek fajkonjtë.

Por tani, tregtia e paligjshme po bie në mënyrë të theksuar, dhe jo për shkak të forcimit të ligjit, por për shkak se nuk ekzistojnë më skifterë.

Në Kazakistan, p.sh., vlerësohet të kishte vetëm 100-400 çifte të këtij skifteri, ndërkohë që para rrezimit të Bashkimit Sovjetik kishte rreth 3 000-5 000 çifte.

### MËNYRA E TË USHQYERIT

Fëmiçet janë viktimat të pavetëdijshme të një dëziteti energjent që rrezikon të transformohet në një "fshikullim" të vërtetë të mirëgenies, siç po ndodh në SBEA. Në Itali një fëmiçë në dhjetë është dëz, një në tre rrezikon të bëhet duke qenë ndërkohë në mbipeshë. Nën akuzë janë lëvizjet e pakta dhe sidomos dieta shumë e pasur me sheqerna dhe yndyrza. Këshillohet t'i çoni fëmiçet "të tërbohen" në park dhe s'ka rëndësi nëse bëhet pis, dhurojini tpa dhe patina në verd të videolojrave, kur janë në tavolinë fikini televizorin dhe ndërkohë nësojini të shijojnë atë që hanë dhe kënaqësinë (në pak është më mirë).

### STUDIMI MBI ORIGJINËN E NDOTJES SË AJRIT

Nga data 1 mars -15 maj NASA dhe partnerët e saj ndëmorën një eksperiment interkontinental për transportet kimike në ajër. Ky eksperiment është në fazën e tij të dytë për studimin e transportit dhe evolucionit të gazeve dhe pjesëve të vogla të qajtura aerosolë, të cilat kalojnë përmes kontinenteve dhe përcaktojnë efektin që kanë këto të fundit në klimën dhe cilësinë e zonave ajrore. Gjatë këtij eksperimenti kërkuesit ndoqën origjinën e ndotjes, ku së fundmi është gjetur edhe origjina e tij, e cila ndodhet në Amerikën e Veriut dhe që ndot ajrin në troposferë, e cila është më afër atmosferës, pjesa ku ne jetojmë dhe marrim frymë. Si pjesë e vazhduese e këtij eksperimenti NASA do të ndëmarzë edhe një tjetër studim të quajtur "Ndikimi i qyteteve të mëdha në rajon dhe në mjedisin botëror" (MIRAGE). Eksperimentet pritet të kryen në qytetet e mëdha të botës me rreth 10 milion banorë. Këto qytete prodhojnë përqendrim atmosferik të ndotjes, të

## Shkurt nga bota

cilat i tejkalojnë standardet mëkombëtare. Aktualisht kjo gjendje ndikon drejtpërsëdrejti në shëndetin e njeriut. "Bota është drejt urbanizimit", thotë shkencëtarja Sasha Madronik. Faza e parë e këtij eksperimenti eksploroit përbërjen dhe transportin e ajrit nga U.S në Evropë.

Burimi: NASA Qendra e Fluturimeve Ajrore  
Përshtati: Anila Vako, OKE-AL

### ZBULOHEK NË BORNEO GJARPRI QË NDRYSHON NGJYRË

Ndryshon ngjyrë si kameleon, por është gjarpër. Iste WWF-ja ajo që e zbuloi këtë specie të re në pyjet e Borneos, të ripagëzuar si "gjarpri i baltës të Kapuas", duke qenë se



gjarpërinjtë me këto karakteristika janë shumë të mallë dhe duket se jetojnë vetëm në zonat e lagëta të lumit Kapuas në Borneo. Lloji Bhydris, së cilës i pëket gjarpri, përbëhet nga 22 specie, nga të cilat vetëm dy janë shumë të përhapura, mësa të tjerat janë shumë të mallë. Në ishullin e Borneos janë zbuluar 361 specie të reja kafshësh dhe bimësh këto dhjetë vjet, që do të thotë tre specie në muaj, në një rajon që është vetëm sa dyfishi i Gjermanisë. Zbulimi i kësaj speciejë gjarpri me aftësi mimetike zbulon një tjetër vlerë të jashtëzakonshme të sekreteve të natyrës në "zanër të Borneos". Ndoshta kjo aftësi e tij e ka mbajtur të fshehur nga shkenca deri tani. Për fat të keq ambienti i kësaj speciejë kërcërohet seriozisht, duke qenë se tani në Borneo ekziston vetëm gjysa e pyjeve të dikursime. Megjithatë, ekziston shpresa që kjo tendencë të frenohet, pasi tre qeveritë e Borneos kanë marrë nën mbrojtje 220 000 km<sup>2</sup> të pyjeve ekuatoriale.


### Të ndëruar nxënës, mësues, prindër!

Qendra "EDEN" dhe Bashkia e Tiranës ju ftojnë të merri pjesë edhe ju në fushatën për ndarjen dhe riciklimin e letërës.

Le të punojnë të gjithë së bashku për të pasur një mjedis në të pastër dhe më të shëndetshëm.



Botimi i këtij numri të "Ekolëvizjes" u sponsorizua nga OSCE



STAFI

EDITORI - Xhemal MATO  
Kryeredaktor - Kastriot MAHILAJ  
REDAKTORE  
Ornela SHOSHI  
Rovena TASHI

Adresa e redaksisë: Ish- klinika qeveritare, shkalla 3, kati IV, Tiranë  
Tel.: 04 234 851, Cel.: 068 21 82081 e-mail: ekolevizja@yahoo.com

TIRAZHI: 600 KOPJE